

REALIZIMI I TREGUESVE EKONOMIKO FINANCIARE TE VITIT 2014

A. Struktura e te ardhurave te realizuara

Ne menyre te detajuar burimet, nepermjet te cilave RTSH ka realizuar te ardhurat gjate kesaj periudhe jane:

Nr.	Burimi	Te ardhurat ne 000/leke
1	Financimi nga Buxheti i Shtetit	357,000
2	Tarifa mbi Aparatin Marres radio televiziv	1,368,550
3	Transmetimet me jashte nga tranmtimet ne FM dhe vale te shkurtra	170,639
4	Kontratate e sherbimit per paisje radiotelevizive ne ambientet e RTSH	40,704
5	Reklammat,njoftimet kronikat etj	113,968
6	Kontrata radiobashkepunimit me Kinen	74,000
7	Te ardhura te tjera,rimb.shpenz.cerrik,interesa etj.	162,215
	TOTALI	2,306,473

Ne menyre te permbledhur te ardhurat sipas dy burimeve te financimit jane realizuar ne raportet dhe ne strukturen e meposhtme :

-Te ardhura te vete RTSH	ne vleren	1,949,473 Mije leke (ose 85% ndaj totalit)
-Te ardhura te financuara nga Buxheti	ne vleren	357,000 Mije leke (ose 15% ndaj totalit)

Grafikisht perqindjet e realizimit te te ardhurave paraqiten :



Per here te pare qe nga arketimi i tarifes se aparatit marres rtv, perqindja e realizimit te saj ka arritur nivelin 59% ndaj totalit te te ardhurave te RTSH. Per tu theksuar mbetet fakti qe gjate vitit 2014 kjo e

ardhur eshte arketuar ne menyre kronologjike dhe ne perqindje ne rritje,vecanerisht ne dy muajt e fundit Nentor, Dhjetor 2014.

B. Realizimi i te ardhurave ne krahasim me planifikimin gjate te vitit 2014

Ne 000/leke

TE ARDHURAT	Planifikimi i Vitit 2014	Realizimi i Vitit 2014	% e realizimit
I Financimi nga buxheti	357,000	357,000	100%
Bashkatdhetaret&Sateliti	240,000	240,000	100%
Projekte Filmike&Artistike	62,000	62,000	100%
Orkestra Simfonike RTSH	55,000	55,000	100%
II.Te ardhura te Institucionit	1,718,000	1,949,473	113%
Te ardhura nga taksa aparatit	1,140,000	1,368,550	120%
Qera ambjentet transmetuese RTSH	40,000	40,704	102%
Transmetim Radio per te trete	162,000	170,639	105%
Reklama,njoftime etj.	122,000	113,968	93%
Kontrata Radiobashkp.Kinen	74,000	74,000	100%
Te ardhura te tjera	180,000	181,612	101%
TOTALI I+II	2,075,000	2,306,473	111%

Te ardhurat jane realizuar ne masen 111% ne krahasim me planifikimin ,pra me nje rritje prej 11% ose ne vlere absolute me nje tejkalim prej 231,473 mije leke.

I-Te ardhurat nga buxheti jane realizuar ne nivelin e planifikuar ne te tre zerat kryesore :

a)Bashkatdhetaret dhe Programi Satelitor


b)Orkestra Simfonike e RTSH

c)Zeri Projekte Filmike e Artistike

Ky financim eshte terhequr rregullisht cdo muaj ne baze te parashikimit buxhetor dhe situacioneve faktike te percjella nga Drejtoria Radio Tiranes, Drejtoria e Stacioneve Transmetuese RTSH, Drejtoria e Programit Satelitor etj.

II-Te ardhurat e realizuara nga vete RTSH kane patur ecurine si vijon :

1. E ardhura nga tarifa e ap.rtv ne fakt eshte realizuar ne vleren 228,550 mije leke me shume se planifikimi vjetor. Gjate vitit 2014 ,fale nje bashkepunimi te strukturave Drejtuese te RTSh dhe Kompanise Cez,tani OSHEE, e ardhura nga kjo tarife ka arritur jo vetem nivelin me te larte te arketimit te saj qe nga fillimi,por edhe arketimin ne cdo muaj te vitit,duke krijuar sigurine ne Institucion per realizimin e buxhetit vjetor si edhe per krijimin e rezervave per nisjen e procesit te dixhitalizimit ne RTSH.Me poshte paraqesim nje kurbe te arketimit te kesaj tarife gjate vitit 2014.



Niveli me i larte i arketimit ka qene muaji Gusht 2014, pasi ne arketimin e shumes se muajit eshte perfshire edhe arketimi i nje vlere ~340,000 mije leke difference e paarketuar e vitit 2013. Gjithashtu edhe ne muajt e fundit shihet nje rritje e nivelit te arketimit, nga likuidimi i detyrimeve te prapambetura te subjekteve debitore ndaj OSHEE.

2. Te ardhurat nga transmetimet radio me jashte paraqiten te realizuara ne nivelin e planifikimit. Tejkalmi ka ardhur nga rritja e kursit te kembimit gjate periudhes se sherbimit ne krahasim me kursin e kembimit llogaritur gjate periudhes se planifikimit. Problematika e ketij zeri ka qene disi me Kontraten me China Radio International, pasi kjo kontrate perfundonte ne muajin mars 2014 dhe vetem me date 22 tetor 2014 ,pala kineze ka konfirmuar shtyrjen e afatit te kesaj kontrate deri ne fund te vitit 2014.

Rinovimi i kontrates edhe per vitin 2015 mbetet detyre urgjente e RTSH, per te patur ecurine normale te kletij zeri te ardhurave edhe per vitin 2015 e ne vazhdim.

3. Te ardhurat nga sherbimi ne ambientete transmetuese te RTSH eshte realizuar ne nivelin e planifikimit. Kontratat e parashikuara nga drejtoria Teknike jane realizuar ne nivel planifikimi.

4. Te ardhura nga Koorporata e Pergjithshme e Radio-Televizionit te Kines per bashkepunim Nderkombetar Tekniko-Ekonomik, ne baze te kontrates se Pergjithshme te RadioBashkepunimit ne vale te shkurtra midis Shqiperise dhe Kines, ka likuiduar vleren e parashikuar ne kontrate prej 550,000 USD ne muajin qershor te vitit 2014.

Gjithashtu nga granti kinez parashikuar ne kontraten e mesiperme, nga Njesia e Prokurimit kane mberitur praktikat e vleres 149,906USD, realizuar gjate kesaj periudhe..

5. Ne zerin e reklamave, njoftimeve etj gjate ketij mbetet parealizuar planifikimi vjetor ne masen ~7%. Ky mosrealizim ka patur si argument nderprerjen e njeanshme te marreveshjes me kompanine Eagle Mobile per vazhdimesine e kontrates ,nderkohe qe ky subjekt ishte parashikuar te ishte dhe sponsor ne festivalin e Fundvitit ne RTSH.

6. Ne zerin e te ardhurave te tjera gjithashtu ka realizim te planifikimit vjetor, duke perfshire te ardhurat nga rimbursimi per radiostacionin e Cerrikut, Shoq.aksionere Eutelsat sa, te ardhura te ndryshme nga organizma nderkombetare, qera lokale, kullotash, pajisjesh, shitje biletash etj.

C. Krahasimi i te ardhurave me vitin e kaluar

Ne 000/leke

TE ARDHURAT	Viti 2013	Viti 2014
I Financimi nga buxheti	352,000	357,000
Bashkatdhetaret&Sateliti	235,000	240,000
Projekte Filmike&Artistike	62,000	62,000
Orkestra Simfonike RTSH	55,000	55,000
II.Te ardhura te Institucionit	1,042,148	1,949,473
Te ardhura nga taksa aparatit	564,566	1,368,550
Qera ambjentet transmetuese RTSH	37,367	40,704
Transmetim Radio per te trete	168,415	170,639
Reklama,njoftime etj.	58,800	113,968
Kontrata Radiobashkp.Kinen	70,000	74,000
Te ardhura te tjera	143,000	181,612
TOTALI I+II	1,394,148	2,306,473

Te ardhurat gjate vitit 2014 paraqiten me nje rritje prej 65% ose 912,325 mije leke me shume se viti 2013,rritje ne te cilin kane ndikuar me perqindjet me te medha: tarifa aparatit rtv dhe reklammat e njoftimet,si rezultat i transmetimit te kampionatit boteror te futbollit Fifa 2014.

II. Struktura e shpenzimeve te RTSH gjate vitit 2014

A. Struktura e zerave te shpenzimeve te RTSH ne menyre analitike

Nr.	Emërtimi	Shpenzimet 000/lek
1	Paga, shperblime , sig.shoqeror	735,020
2	Materiale,lende djegese	43,249
3	Projekte filmike, artistike etj	181,706
4	Organizma Nderkombetar	110,654
5	Sherbime nga te trete si : en.el., uje, telekom, roje civile	194,899
6	Shpenzime udhetimi e dieta	66,308
7	Shpenzime te tjera operative (honorare, pritje percj. etj)	36,938
8	Shpenzime per investime	70,221
	TOTALI	1,438,995

Struktura e shpenzimeve ne menyre grafike ne % paraqitet si vijon:



B. Realizimi i shpenzimeve ne krahasim me planifikimin gjate vitit 2014

Ne 000/leke

Nr	Emertimi	Plani vjetor	Realiz.viti 2014	% e realizimit
1	Paga,shperblime ,sig.shoqeror	739,850	735,020	99%
2	Materiale, lende djegese	64,050	43,249	68%
3	Projekte filmike, artistike, etj	200,000	181,706	91%
4	Organizma Nderkombetar	129,000	110,654	86%
5	Sherbime nga te trete	217,470	194,899	90%
6	Shpenzime udhetimi e dieta	67,650	66,308	98%
7	Shpenzime te tjera operative	39,900	36,938	93%
8	Investime	92,000	70,221	76%
	TOTALI	1,549,920	1,438,995	93%
8.1	Invetime per proj.dixhitalizimit	495,080	0	
9	Fondi I prodhimit te pavarur	30,000	0	
	TOTALI	2,075,000	1,423,775	67%

Nga te dhenat e mesiperme shpenzimet jane realizuar ne masen 93%(pa perfshire mosrealizimin ne zerin Investime per projektin e dixhitalizimit te RTSH dhe fondin e prodhimit te pavarur si praktika e pare ne parashikimin ne buxhetin e RTSH ne zbatim te ligjit 97/2013 date 04.03.2013 Per Mediat audiovizive ne Republiken e Shqiperise, neni 123 Fondi i Prodhimit te Pavarur, vlerat e mosrealizimit te te cileve mbarten ne vitin 2015.

Ne menyre analitike zerat paraqiten si vijon :

1. Zeri Paga ,shperblime e sigurime shoqerore eshte realizuar ne masen 99%.Ne pergjithesi ky ze eshte brenda limiteve te planifikimit te gjitha drejtorite e sistemit,pas miratimit te ndryshimeve qe u bene ne buxhetin e RTSH ne muajin shtator 2014.

2. Zeri Materiale,lende djegese eshte realizuar ne masen 68%. Ne kete mosrealizim vleren me te madhe e paraqet Drejtoria e Stacioneve Transmetuese RTSH ,e cila ka nje realizim te ketij zeri ne masen 30% dhe kjo per arsye se nje pjese e materialeve parashikuar ne kete ze, u realizua ne procesin e tenderimit realizuar ne Drejtorine e Pergjithshme.

3. Zeri Projekte Filmike e artistike eshte realizuar ne masen 91% ne krahasim me planifikimin vjetor 2014.

Gjate kesaj periudhe ne Drejtorine e Televizionit jane realizuar projekte ne vleren 21,031 mije leke dhe konkretisht Jo vetem kafe, Rubrika Sportive, Duel, Njerez te humbur, Fadil Kraja, Netet e Klipit 2014, Kampionati Boteror i Futbollit 2014, Gjithshka shqip, Drejtperdrejt, Shih programin, Tre Tenoret, Makina e shqiptareve, Udhetim ne Shije, Vdekje me porosi, Person Grata, Enderr kuq e zi, Dadoja ne pallatin tone si dhe diferenca te projektit te programit te Vitit te Ri 2013, miratuar me vendime te Bordit te Administrimit RTSH.

Ne Drejtorine e Pergjithshme vlere prej 138,000 mije leke perbehet nga projekte te miratuara me vendime te Bordit te Administrimit e Keshillit Drejtues te RTSH(99,753 mije leke) dhe konkretisht Valet e Drinit, Radioperralla, Eurosong, Cdomethene te Falesh, Arbereshet, Amsterdam Ekspres, shoqata Hemofilise, semafor, Kush do behet milioner, Sa kam shpirt kam shprese, Fadil Kraja, MarieKraja, AlbaniaTravel, Festivali Artit Kulinar, Era Film, Milenium, Familja Unesco/ebu, Sofra shkodrane, Miss globe, Festivali kenges RTSH 2014, ndersa vlere 38,907 mije perbehet nga shitja e te drejtave tv dhe transmetimi per filma, dokumentare dhe evenimente sportive.

Ne Drejtorine e Radio Tiranes vlere e projekteve 19,990 mije leke perbehet nga emisionet Shih programin, Gare, Fjala Artistike, P70/70, Vu Vu Samba, Miresevjen gare, Gezojme, Udhetojme drejt Europes,Nje dite me ju dhe difference e Festivalit te kenges RTSH viti 2013, miratuar me vendimet perkatese te BA dhe KD.

Ne Drejtorine e Aktualitetit ne vleren 1,500 mije leke eshte perfshire projekti Biblioteke.

Ne Drejtorine e Programit Satelitor vlere prej 1,299 mije leke eshte Projekti Shqiperia Kreative, Memedheu dhe Emblema Kadare .

Diferenca e mosrealizimit ne % te vogel ne kete ze lidhet kryesisht me realizimin ne fakt te shpenzimeve te projekteve te fund vitit ,te cilat pritet te realizohen ne fillim te vitit 2015.

4. Zeri Organizma Nderkombetare eshte realizuar ne masen 86%.

Gjate vitit 2014 RTSH ka likuiduar te gjithe detyrimet me Eutelsat,EBU,Ses Astra si edhe me te gjithe organizmat e tjere nderkombetare .Diferenca nemosrealizim vjen vetem si rezultat i mberritjes me vonese te faturave te muajit Dhjetor ,likuidimi i te cilave do te conte ne realizimin 100% te ketij zeri.

5. Zeri i sherbimeve nga te trete eshte realizuar ne masen 90%.

Mosrealizimim vjen kryesisht ne zerin e Energjise Elektrike(87% realizim) dhe zeri Sherbim rojet civile (82%realizim)ne Drejtorine Stacioneve Rtv dhe Drejtorine e Pergjithshme .Diferencat ne zerin e energjise elektrike kryesisht ne Drejt.Stacioneve rtv dhe Radio Tiranes shpjegohen me parashikimin e kryer duke marre parasysh nje rritje te mundshme te en.elektrike,gje qe ne fakt nuk ndodhi ne vitin 2014.

Diferencat e medha ne zerin e rojeve civile jane edhe si rezultat i mosplotesimit te dokumentacionit te rregullt nga ana e firmes dhe per kete arsye nuk jane kryer edhe pagesat.

Me kursime paraqiten realizimet ne te gjithe zerat e tjere te shpenzimeve te ketij grupi.

6. Zeri i shpenzimeve udhetim e dieta eshte realizuar ne masen 98%.

Gjate ketij viti ,ndryshe nga viti i kaluar jane zhvilluar udhetime ne kuader te marrjes se statusit te vendit kandidat ne BE,te zgjedhjeve ne Kosove,transmetimit nga Brazili te kampionatit Boteror te Futbollit Fifa 2014 si edhe pasqyrim te ndeshjeve te futbollit organizuar jashte Shqiperise me stafin realizues te RTSH,trajnime te ndryshme etj. Ne kete kuader jane bere edhe ndryshimet ne rritje ne kete ze.Gjithashtu gjate ketij viti ,ne gjashtemujorin e pare,shume projekte kaluan ne programme te struktures dhe si te tilla keruan rritje te ketij zeri kryesisht ne televizion.Diferenca ne mosrealizim shihet kryesisht ne Drejtorine e Radio Tiranes.

7. Zeri i shpenzimeve te tjera operative eshte realizuar ne masen 93%.

Ne total ky ze paraqitet brenda kufijve te planifikimit,vetem ne zerin shp.tat.taksa te tjera ka nje tejkalim te vogel qe nuk ndikon ne totalin e shpenzimeve,i cili vjen kryesisht si rezultat i nje procesi te humbur gjygesor per shkarkimin nga puna te nje punonjese te Drejtorise se Programit Satelitor..

8. Zeri Fondi i prodhimit te pavarur nuk eshte perdorur gjate ketij viti dhe mbetet te perdoret ne periudhen ne vijim ne baze te procedurave te ligjit

9. Zeri Investime. Realizimi ne kete ze eshte ne masen 76%.

Ndikim negativ ne kete realizim ka patur mosrealizimi ne Drejtorite e Radio Tiranes,Radiove lokale dhe Drejtorise se Programit Satelitor ne vlere totale 32,000 mije leke mosrealizim. Gjate kesaj periudhe ne kete ze jane te perfshira vlere 8,598 mije leke blerje dhe instalim mixer dekodez zeri, 4,932 mije leke blerje dv cam sony , 4,140mije leke blerje autoveture, 10,915 mije leke blerje llampa transmetimi dhe 27,384 mije leke blerje instalim pjese SNG,radiorele,antena,aksesore.Gjithashtu edhe vlere e grantit kinez eshte perfshire perkatesisht ne Drejtorine e Televizionit,ne Drejtorine e Aktualitetit dhe ne Drejtorine e Arkives ne Drejtorine e pergjithshme te RTSH.

Ndersa mosrealizimi i vleres se parashikuar 495,080 mije leke lidhet me projektin e dixhitalizimit te RTSH

Gjate ketij viti ishin parashikuar nje sere investimesh teknologjike, mjaft te rendesishme.

1. Investimi per rikonstrukcionin e plote te kabines elektrike, qe sipas parashikimeve do te shkonte deri ne120,000 mije leke.
2. Investime per ndertimin e "Digitalb RTSH", pra per strukturen qe do lejoje transmetimin, me te gjitha kerkesat e duhura, te nje numri te madh programesh, ne drejtim te transmetimit dixhital te programeve tokesore te RTSH. Ky investim do ishte rreth 130 ,000 mije leke.
3. Nje sere investimesh per RTV lokale, ne masen rreth 10,000 mije leke. Te gjitha keto investime jane shtyre per me vone, per arsye se ende nuk ka filluar projekti i dixhitalizimit te teknologjise se transmetimeve tokesore te RTSH-se, i cili parashikohej te fillonte gjate vitit 2014.

Ky projekt,do te shoqerohej me nje pagese te menjehershme prej 15% te vleres se Pergjithshme nga RTSH. Gjate ketij viti parashikohej nje pagese e menjehershme per kete qellim. Nisur nga sa me siper, eshte vendosur qe per investimet e tjera do veprohet gjate vitit 2015, pas firmosjes se kontrates per transmetimet tokesore dixhitale.

2014.**Pesha e shpenzimeve te cdo drejtorie ndaj totalit te shpenzimeve eshte si vijon :**

- Drejtoria e Televizionit	19%
- Drejtoria e Radio Tiranes	13%
- Drejtoria Stacioneve .rtv	17%
- Drejtoria Aktualitetit	7%
- Drejtoria Programit Satelitor	2%
- Drejtorite e Radiove lokale	1% secila

Ne Drejtorine e Pergjithshme perqindja eshte ~38%, por ne kete drejtori jane perqendruar shpenzimet per Investime, Projekte filmike e artistike, Oorganizma Nderkombetare, Shperblime, Materiale dhe Ssherbimi per te trete, te cilat i sherbejne te gjitha drejtorive te struktures se RTSH.

C. Krahasimi i Shpenzimeve te viteve 2013, 2014

Ne 000/leke

Nr	Emertimi	VITI 2013	VITI 2014
1	Paga,shperblime ,sig.shoqeror	696,438	735,020
2	Materiale, lende djegese	46,422	43,249
3	Projekte filmike, artistike,etj	200,258	181,706
4	Organizma Nderkombetar	114,243	110,654
5	Sherbime nga te trete	154,748	194,899
6	Shpenzime udhetimi e dieta	45,628	66,308
7	Shpenzime te tjera operative	28,392	36,938
8	Investime	57,820	70,221
9	Fondi Prodhimit te pavarur		0
	TOTALI	1,343,949	1,438,995

Niveli i shpenzimeve gjate vitit 2014 ka qene 7% me i larte ne krahasim me vitin 2013.

- Rritja ne zerin paga,sig.shoq etj ~ 5% ,ka ardhur si rezultat i rritjes se pagave ne muajin Prill 2013, si edhe i ndryshimeve strukture gjate vitit 2014.

- Rritja ne zerin e sherbimeve per te trete ka ardhur kryesisht nga sherbime shtese te realizuara gjate ketij viti per te drejten e autorit,sherbime interneti,sherbim kampionati boteror i Futbollit(spotet publicitare),si edhe shpenzimet per transmetimin e ardhjes se papes ne Shqiperi ne muajin shtator 2014.

- Rritja ne zerin e udhetim e dieta dhe shpenzime te tjera operative(honoraret) ka ardhur si rezultat i kalimit ne emisione te struktures i projekteve filmike dhe artistike. Nga sa mund te shihet zeri i projekteve ka nje ulje ne krahasim me te njejten periodhe te vitit te kaluar. Gjithashtu gjate kesaj periodhe te vitit 2014 jane pasqyruar te gjitha ngjarjet per marrjen e statusit te vendit kandidat ne BE, zgjedhjet ne Kosove etj., transmetimin live te evenimenteve sportive nga perfaqesues te RTSH etj.

Te gjitha zerat e tjere jane realizuar pothuaj ne te njejtin nivel si ne vitin 2013.

RTSH gjate vitit 2014 ka ne afat te gjitha detyrimet kontraktore ndaj te treteve dhe ka kryesisht detyrime te krijuara vetem gjate muajit dhjetor,te pritshme per tu likuiduar ne muajin Janar 2015.